

AKT THEMELIMI

A KIND OF BEAUTY & CONSULTING

Ne Tirane, sot me dt 30/05/2024 (dymije e njezeteeater), shtetasja:

Znj. Vitori Kondi, lindur më 18.09.1943 në Brataj Vlore dhe banues ne Vlore me adrese: Lagjia 28 Nentori, Rr. Sadik Zotaj, Pallati 463 Vlore, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtës Leternjoftimit ID me numer personal E35918054R, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

Me vullnet te lire e te plote, si themelues i kesaj shoqerie ne te cilin eshte ortak i vetem e duke u bazuar dhe në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” I ndryshuar dhe legjislacionin e zbatueshëm ne Republikën e Shqipërisë, vendos të hartoje kete statut si dhe pjese integrale te tij Aktin e Themelimit te Shoqerise.

Neni 1

Emërtimi dhe selia e shoqërisë

1.1 Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Rebullikës së Shqipërisë.

Neni 2

Objekti i Shoqërisë

2.1 Objekti i Shoqërisë është :

- Konsulence juridike dhe ekonomike ne fushen e administrates publike si dhe ate civile;
- Trajtime estetike, jo kirurgjikale;
- Vleresime te pasurive, industriale, civile dhe bujqesore;
- Ndermjetesim per shitblerje pasurie te patundshme;
- Rregjistrim marke, patente;
- Ofrimi i selive dhe/ose adresave virtuale për entitete private shqiptare dhe/ose të huaja, ofrimi i qendrave virtuale sekretarie.
- Pjesëmarrja në projekte të ndryshme, përgatitja e Due diligencave për persona fizike dhe/ose juridike.
- Asistenca juridike në kuadër të procedurave te prokurimit, për dhënien me konçesion dhe procedurat e privatizimit;
- Konsulence udhetimesh turistike;
- Veprimtari te tjera te lejuara me ligj.

Aktiviteti i shoqerise nuk do te kufizohet vetem ne keto sherbime apo veprimtari, por do te ushtroje edhe veprimtari te tjera te lejuara me ligj.

2.2 Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara mund të bashkëpunojë me direkt dhe indirekt me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja që kanë objekt analog osë të lidhur me të tyren.

Neni 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë. Viti ushtrimor

3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat te pacaktuar.

3.2 Viti i parë financiar do të fillojë nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregëtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) Tiranë dhe do të përfundojë në 31 Dhjetor.

3.3 Vitet e mëtejshme financiare fillojnë më 1 Janar dhe përfundojnë me 31 Dhjetor.

Neni 4

Kapitali themeltar

4.1 Kapitali themeltar u nënshkruar dhe i paguar i shoqërisë është 10.000 (dhjete mijë leke) dhe përbëhet tërësisht nga kapital në para. Kapitali themeltar ndahet në 1 (një) kuote me vlerë nominale të barabartë prej më vlerë prej 10.000 (dhjete mijë) Lekë.

4.2 Në bazë të kontributit të paguar, pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin themeltar është Zj. Vitori Kondi. Zoteron 100% te kuotave te kapitalit themeltar ose 1 kuote.

Neni 5

Asambleja e Përgjithshme

5.1 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e përcaktuara në Ligjin për Shoqëri tregtare . Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet dhe sipas mënyrës së thirrjes të përcaktuara në statusin e shoqërisë.

Neni 6

Administratori

6.1 Shoqëria do të administrohet nga një Administrator. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë Zj. Vitori Kondi. Afati i emërimit të Administratorit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje.

Neni 7

Kostot e themelimit

7.1 Të gjitha kostot, pagesat dhe shpenzimet lidhur me themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë do të merren përsipër nga shoqëria të cilat do të përfshihen në llogarinë e parë vjetore financiare në shumën e atyre aktuale.

Neni 8

Njoftimet

8.1 Njoftimet për orataket do të kryhen me postë të regjistruar në adresën e kompanisë më të fundit të komunikuar nga çdo ortak, me përjashtim kur parashikohet ndryshe nga ligji apo statuti.

8.2 Njoftimi mund të bëhet edhe nëpërmjet postës elektronike, në momentin e krijimit të kësaj teknike që kërkohen sipas ligjit.

Neni 9

Dispozita të fundit

9.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me këtë akt themelimi, me statutin e saj dhe ligjin shqiptar.

Neni 10

Kopje

10.1 Ky akt themelimi hartohet në 3 kopje, sipas këtij destinacioni, një kopje orataku, një kopje për Qendrën Kombetare të Biznesit (nese do te jete e nevojshme) dhe një kopje për zyrën qendrore të shoqërisë.

**ORTAKU THEMELUES
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“A KIND OF BEAUTY & CONSULTING”
Znj.Vitori Kondi**